

**Analizë Gjinore e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes
së Stabilizim Asocimit
2017-2021 dhe 2018-2022**

Analizë e çështjeve gjinore e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA)

Përgatitur nga: Donjeta Morina dhe Ariana Qosaj-Mustafa

Hulumtimi i mbështetur nga: Blend Zyrapi

© *Instituti Kosovar për Zhvillim dhe Hulumtim të Politikave (KIPRED)*

Copyright © 2019, KIPRED. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Nuk mund të publikohet apo të riprodhohet asnjë pjesë e këtij publikimi, apo të ruhet në ndonjë sistem të rikuperueshëm, ose të shpërndahet në çfarëdo forme, qoftë nëpërmjet ndonjë pajisje elektronike, mekanike, fotokopjimi, regjistrimi apo ndonjë formë tjetër, pa lejen e mëparshme me shkrim nga botuesi. Ju lutemi kontaktoni: info@kipred.org, or +383 38 542 778.

Publikuar nga



Instituti Kosovar për Zhvillim dhe Hulumtim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtina, Kosovo

Tel. dhe fax: +383 38 542 778

Përmbajtja

Shkurtesat	4
I. Hyrje	6
II. Metodologjia e monitorimit.....	8
III. PKZMSA 2017-2021: Pasqyrë e Perspektivës Gjimore	10
IV. PKZMSA 2018-2022: Pasqyrë e Perspektivës Gjimore.....	11
V. PKZMSA 2017-2021 dhe 2018-2022: Përafrimi i akteve kombëtare me legjislacionin e BE-së.....	12
V. a) Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	12
b) Indeksi gjinor	14
c) Programi i Kosovës për Barazi Gjimore	16
VI. PKZMSA 2017-2022 dhe 2018-2022: Masat e implementimit	18
a) Kërkesa lidhur me gjininë për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.....	18
b) Kërkesa në lidhje me gjininë për Këshillin Prokurorial të Kosovës	20
d) Kërkesat lidhur me gjininë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.....	23
f) Gjetje të tjera: Kapacitetet institucionale në zbatimin e kërkesave në lidhje me gjininë	24
VII) Përfundime dhe rekomandime	26
VIII. Bibliografia.....	29
IX Shtojcë.....	31

Shkurtesat

IEBGJ	Instituti Evropian për barazi gjinore
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
BPGJ	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor
AKS	Agjencia Kosovare e Statistikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
PKBG	Programi Kosovar për Barazi Gjinore
RrKG	Rrjeti Kosovar i Gruas
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PKZMSA	Programi Kombëtar për zbatim të MSA-s
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

Përmbledhje ekzekutive

Ligji mbi Barazinë Gjinore i Kosovës Nr. 05/L-020, kërkon që të gjitha ligjet, politikat, strategjitë dhe programet në Kosovë të kenë një perspektivë gjinore të përfshirë përgjatë tyre. Në mesin e shumë dokumenteve strategjike në Kosovë, këtu përfshihet edhe Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA). Në bazë të kësaj kërkesë, ky raport shpalos një analizë gjinore të PKZMSA për periudhën 2017-2021 dhe PKZMSA 2018-2022. Rezultatet e analizës kanë treguar që PKZMSA i parë për periudhën 2017-2021 ka pasur një perspektivë gjinore dhe parashikonte tregues specifikë gjinor. PKZMSA tjetër e cila mbulon periudhën 2018-2022, tregon tendenca të ndryshme shqetësuese, duke mos integruar perspektivën gjinore në përmbajtjen e saj, gjë që ilustron edhe një herë që kërkesat për barazi gjinore nga vendimmarrësit e Kosovës vazhdojnë të neglizhohen edhe më tej. Raporti gjithashtu konstaton se kjo neglizhencë ka vazhduar pavarësisht kërkesave të parashtruara nga Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore, me anë të së cilit kërkohet dhe bëhet e detyrueshme që politikat dhe strategjitë të përfshijnë parimet e barazisë gjinore.

Analiza gjithashtu vë në pah shumë ndryshime sa i përket përmbajtjes së PKZMSA 2017-2021 dhe PKZMSA 2018-2022. Teksa PKZMSA 2017 ka një perspektivë gjinore të integruar në të gjithë pjesën e saj narrative, si dhe në kuadrin e saj logjik, PKZMSA 2018-2022 kryesisht i mungon një perspektivë e tillë. Analiza në këtë raport tregon se kjo vjen si rezultat i ekspertizës së jashtme që është konsultuar në vitin 2017 dhe mos shfrytëzimi i kësaj ekspertize gjatë procesit të hartimit të vitit 2018 të PKZMSA 2018-2022. Sidoqoftë, rezultatet e analizës tregojnë gjithashtu se ndërsa një perspektivë gjinore ishte përfshirë në PKZMSA 2017-2021, ajo nuk u përkthye automatikisht në zbatim. Në fakt, asnjë nga aktet legjislative në lidhje me barazinë gjinore që ishin parashikuar të zbatohen në vitin 2017 nuk janë zbatuar. Kjo përfshin Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, Indeksin e Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe një akt nënligjor që rregullon Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor. Në fakt, këto kërkesa u zhvendosën në vitin 2018 dhe nuk arritën të zbatohen përsëri, dhe janë në pritje të zbatimit të tyre gjatë vitit 2019. Raporti gjithashtu analizon indikatorë të tjerë të ndjeshëm gjinorë të regjistruar nën PKZMSA për vitet 2017 dhe 2018.

Në përgjithësi raporti tregon që përfaqësimi i barabartë gjinor i kërkuar si nga planet e veprimit të PKZMSA dhe nga Ligji për Barazi Gjinore, janë injoruar në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet e shumta përkatëse. Hulumtimi më tej tregon probleme të vazhdueshme për sa i përket kapaciteteve dhe njohurisë themelore sa i përket barazisë gjinore përgjatë institucioneve. Mungesa e kapaciteteve

të identifikuara përfshin mungesën e njohurive mbi kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore dhe kërkesave të PKZMSA që kanë të bëjnë me integrimin gjinor dhe barazinë gjinore, por edhe njohuri shumë të ulëta për çështjet e barazisë gjinore brenda sektorëve të tyre të punës.

I. Hyrje

Kosova mbetet e përkushtuar drejt integrimin të saj në Bashkimin Evropian. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në vitin 2015, Kosova hyri në marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në.¹ MSA hyri në fuqi në vitin 2016. Ajo synon, ndër të tjera, të mbështesë forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë; të sigurojë stabilitetin politik, institucional dhe ekonomik; të mbështesë dialogun politik; të mbështesë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së dhe të mbështesë ekonominë e tregut, etj.² Për më tepër, Zyra e BE-së në Kosovë ka hartuar një proces dialogu të nivelit të lartë me Kosovën, i njohur si "Agjenda për Reforma Evropiane (ARE)" për të shpejtuar zbatimin e përparesive të MSA-së në vitin 2016.³ ARE përcakton prioritetet afatshkurtra në fushat e arsimit, punësimit, konkurrencës, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.⁴ Më tej, për të siguruar zbatimin e MSA-së dhe për t'i mbajtur përgjegjës institucionet, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) hartoi Programin e parë Kombëtar të Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) në vitin 2016.

Barazia gjinore konsiderohet ndër vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian.⁵ Përmes "Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020" i njohur si Plani i Veprimit Gjinor i BE - GAP II, BE e ka bërë barazinë gjinore pjesë të të gjitha politikave të saj të integritimit në BE, përfshirë edhe politikat e zgjerimit dhe fqinjësisë. BE-j i ka bërë kërkesat që lidhen me barazinë gjinore si shtyllën kryesore të MSA-së. Konkretisht, në

¹ Këshilli i Evropës, Marrëveshja për Stabilizim Asociim në mes të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian për Energji Atomike, për njëzën pjesë dhe Kosovën*, 2015, në: data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf

²Ibid. neni 1

³ Shih Seksionin Hyrje në Raportin e Ministrisë së Integritimit Evropian "Raporti Final për Zbatimin e Agjendës së Reformës Evropiane 2016-2018," dhjetor 2018. Në dispozicion në: http://mci-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016-30_11_2018_final_eng.PDF

⁴Ibid.

⁵Komisioni Evropian, Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së, 2016-2020, 2015, në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf

seksionin "Bashkëpunimi Social" MSA kërkon që Kosova të mbështesë mundësi të barabarta për burra dhe gra.⁶ Për më tepër kërkon rregullimin e ligjeve të punës në lidhje me kushtet e punës për gratë.⁷ Për më tepër, ARE kërkon që i gjithë zbatimi i saj të jetë në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore.⁸

Në përputhje me kërkesat e MSA-s dhe ARE-s, PKZMSA 2017-2021 ka një perspektivë të veçantë gjinore të përfshirë në fushën e saj. Ndër të tjera, ajo ka përfshirë një perspektivë gjinore në pjesën e saj narrative, si dhe në kornizën logjike. Ndërsa Ministria e Integrimit Evropian është konsultuar me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe ekspertët për çështje gjinore gjatë përpilimit të PKZMSA 2017-2021, asnjë monitorim vijues i zbatimit të aktiviteteve dhe treguesve të tij në lidhje me gjininë nuk është bërë deri më tani. Në PKZMSA 2017-2021 janë parashikuar gjithsej **20** masa që lidhen me gjininë, duke përfshirë **tre** akte kombëtare që duhet të harmonizohen me Acquis të BE-së dhe **15** Masat/Veprime të zbatimit. Ndërsa PKZMSA-s 2018-2022 i mungon një perspektivë dalluese gjinore e ngjashme me PKZMSA-në e mëparshme, ajo megjithatë ka **tre** akte kombëtare që duhet të përafrohen me *Acquis* të BE-së, si dhe tre masa/veprime zbatimi të përkufizuara.

Raporti njih rëndësinë e veçantë të treguesve dhe planeve të ndjeshme gjinore, si dhe nevojën për të monitoruar zbatimin e të gjitha veprimeve dhe treguesve në lidhje me gjininë brenda PKZMSA. Në përputhje me MSA-në, PKZMSA dhe ARE, analiza e më poshtme thekson gjetjet kryesore që lidhen me monitorimin e zbatimit të kërkesave lidhur me çështjet gjinore brenda PKZMSA 2017-2021, si dhe PKZMSA 2018-2022.

⁶ Këshilli i Bashkimit Evropian, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Kosovës, neni 106, at: data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf

⁷MSA, Neni 106

⁸Qeveria e Kosovës, Agjenda për Reforma Evropiane 2016, at: mei-ks.net/repository/docs/20170929090420_erafinalsq.pdf

II. Metodologjia e monitorimit

Gjatë hulumtimit dhe përpilimit të këtij raporti të politikave janë përdorur disa qasje të ndryshme metodologjike. Një analizë fillestare e kërkesave të cilat lidhen me çështjet gjinore është kryer sipas PKZMSA 2017-2021 me qëllim të identifikimit dhe hartimit të një bazë të të dhënave të monitorimit së bashku me të gjitha të dhënat përkatëse të përpiluara, duke përfshirë edhe treguesit e identifikuar përkatës të gjinisë. Për më tepër, plani i veprimit i monitorimit ka përfshirë gjithashtu edhe analizën e PKZMSA 2018-2022 dhe azhurnimi i kërkesave ekzistuese lidhur me gjininë. Analiza është fokusuar në dy raportet e PKZMSA për periudhat 2017-2021 dhe 2018-2022, pasi gjatë analizës është vërejtur se pak nga kërkesat në lidhje me gjininë për PKZMSA të parë 2017-2021 mbetën të paplotësuara nga institucionet. Për më tepër, kur u hartua PKZMSA e dytë që përfshin periudhën 2018-2022, disa nga këto kërkesa janë lënë anash. Prandaj, qasja e ekipit të hulumtimit ishte që t'i kushtojë vëmendje të madhe kërkesave që nuk përmbushen në të dyja planet e veprimit dhe të sigurojë rekomandime konkrete për palët e interesuara se si të përmirësohet zbatimi i kërkesave lidhur me gjininë, të cilat janë të parashikuara nga ligjet e Kosovës brenda politikave ekzistuese. Në veçanti, hulumtimi fillon me kërkesat kryesore të Legjislacionit të Kosovës në lidhje me barazinë gjinore, gjegjësisht Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore (2015) dhe kërkesat e tij lidhur me barazinë gjinore, integrimin gjinor dhe pjesëmarrjen e barabartë gjinore të përcaktuara dhe reflektuar drejtpërdrejt në PKZMSA 2017- 2021.

Analiza identifikoi kërkesat kryesore lidhur me çështjet gjinore dhe, rrjedhimisht, hartoi një bazë të të dhënave monitoruese duke radhitur institucionet kryesore përgjegjëse për zbatim, institucionet mbështetëse, afatet kohore për shpërndarjen dhe vlerësimin e nevojave të kapaciteteve. Si PKZMSA 2017 ashtu edhe PKZMSA 2018 u monitoruan në mënyrë që të krijojnë një vlerësim dhe të identifikojnë nivelin e zbatimit të kërkesave ekzistuese dhe të vëzhgojnë nëse këta tregues janë duke u zbatuar. Raporti nuk vëzhgon PKZMSA 2019-2023 pasi ai është akoma duke u zbatuar dhe do të monitorohet për zbatim në fillim të vitit 2020. Gjatë ciklit të dytë të analizës së kërkesave të PKZMSA lidhur me gjininë për periudhën 2019-2023, KIPRED do të analizojë gjithashtu nivelin e zbatimit të këtyre kërkesave në nivelin komunal për disa komuna të paracaktuara dhe do të vëzhgojë rolin e ministrive përkatëse ndaj zbatimit të këtyre kërkesave, duke përfshirë edhe koordinimin.

Baza e të dhënave e monitorimit me kërkesa që lidhen me gjininë u përdor si mjet kryesor i analizës për procesin e hulumtimit dhe hartimit. Për më tepër, një hulumtim në tavolinë dhe analizë ligjore e dokumenteve ekzistuese është kryer, duke identifikuar kërkesat përkatëse në lidhje me gjininë dhe

duke analizuar se cilat nga kërkesat janë përmbushur ose jo. Më pas, KIPRED ka realizuar një sërë intervistash gjysmë të strukturuar me zyrtarët e Ministrisë së Integritit Evropian dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përfshira në zbatimin e kërkesave lidhur me gjininë. Kjo është bërë me qëllim të verifikimit të informacionit ekzistues, kërkimin e informacionit të ri në lidhje me zbatimin si dhe identifikimin e sfidave në zbatim. Një sërë intervistash u kryen me të gjitha institucionet përkatëse, me listën e plotë të institucioneve të intervistuar të cilat mund të gjenden në Shtojcën 1 të këtij raporti të politikave. Intervistat kishin për synim të vlerësonin në thellësi nivelin e njohurive të kërkesave lidhur me gjininë, nivelin e njohjes së ligjeve përkatëse të Kosovës që adresojnë barazinë gjinore, si dhe matjen e dy niveleve të zbatimit dhe të identifikimit të sfidave të hasura gjatë zbatimit.

Gjatë intervistave u identifikuan praktikat dhe sfidat më të mira dhe, rrjedhimisht u hartuan një seri rekomandimesh dhe janë dhënë për hartuesit kryesorë të politikave dhe palët e interesuara përgjegjëse për të zbatuar kërkesat e PKZMSA lidhur me gjininë. Për më tepër, KIPRED ka përgatitur gjithashtu fletë faktike (fact sheets) të cilat janë lehtë të shfrytëzueshme, lidhur me gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raportit, pyetjet më të shpeshta, sfidat e zakonshme që do t'u shpërndahen zyrtarëve përkatës në Ministrinë e Integritit Evropian dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Të gjitha rekomandimet do të dorëzohen nëpërmjet grupeve punuese me anë të diskutimeve të bazuara dhe të organizuara nga KIPRED bashkë me zyrtarë përkatës. Rekomandimet e përbashkëta do të hartohen në përputhje me nevojat institucionale përgjegjëse

III. PKZMSA 2017-2021: Pasqyrë e Perspektivës Gjinore

PKZMSA 2017-2021 kishte kërkesa në lidhje me çështjet gjinore të përfshira në të gjithë pjesën e saj narrative. Në të vërtetë, vetë dokumenti thekson se integrimi gjinor i programit ishte një nga pjesët thelbësore të rishikimit të vetë programit.⁹ Rishikimi ishte kryer nëpërmjet një grupi punues me përfaqësues nga shoqëria civile, duke përfshirë edhe Rrjetin e Grave të Kosovës, Qendrën Kosovare për Studime Gjinore dhe UN Women, si dhe përfaqësues nga Ministria e Integritimit Evropian dhe Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ). Ky rishikim profesional është evident përgjatë tërë dokumentit. Në mes të tjerash, PKZMSA 2017-2021 kërkon integrim dhe bashkërendim gjinor në bazë të Ligjit 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore me të gjitha ligjet e përmendura brenda këtij organi. Më tej kërkohet ndarja gjinore e të gjitha të dhënave statistikore të përmendura në vetë dokumentin, si dhe zbatimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) në të gjitha proceset fiskale dhe shpenzimet, përfshirë shpenzimet kapitale. Disa nga ligjet e përmendura në PKZMSA 2017-2020 theksojnë dokumentet kryesore që duhet të përfshijnë një perspektivë gjinore, përfshirë p.sh. Planin Strategjik të Kuvendit të Kosovës 2015-2020, Strategjinë e Qeverisjes të Qeverisë së Kosovës (QK) 2016-2020, duke integruar një perspektivë gjinore në kurrikulat ekzistuese shkollore, Strategjinë e trajnimit të prokurimit publik (2014-2018), Strategjia Kombëtare të Prokurimit Publik (2016-2020), etj. Sidoqoftë, PKZMSA 2017-2021 përdor frazën "sipas kërkesave të organizatave të shoqërisë civile" para secilës kërkesë të lidhur me gjininë. Në fakt, kjo frazë është përdorur 41 herë përgjatë tërë dokumentit. Duhet të theksohet se integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacionin qeveritar është një kërkesë specifike e Ligjit 05/L-020 për Barazinë Gjinore.¹⁰ Duke e shpallur këtë si vetëm një kërkesë të organizatave të shoqërisë civile që punojnë rreth barazisë gjinore nuk e pranon faktin që integrimi gjinor është përgjegjësi e detyrueshme dhe

NPISAA 2017-2021 përdor shprehjen "sipas kërkesave të organizatave të shoqërisë civile që merren me barazinë gjinore" 41 herë. Në të gjitha rastet, kjo frazë është përdorur kur iu referohemi kërkesave specifike që rrjedhin nga Ligji 05/L-020 për Barazinë Gjinore.

⁹Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (PKZMSA), 2017-2021, faqe 9, at: <http://mei-ks.net/repository/docs/pkzmsa20172021ang.pdf>

¹⁰Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore neni 5.1.3. 2015, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

ligjore e paraparë nga Qeveria e Kosovës me qëllim që të reflektohet në të gjitha politikat në përputhje me kërkesat të cilat parashihen në Ligjin për Barazi Gjinore.

Sidoqoftë, përveç këtij lëshimi, seksioni narrativ i PKZMSA 2017-2021 është hartuar shumë mirë, veçanërisht për shkak të përfshirjes së lartë nga ana e ekspertëve të jashtëm në lidhje me çështjet gjinore nga radhët e shoqërisë civile.

Një perspektivë gjinore është përfshirë gjithashtu në Kornizën Logjike të PKZMSA 2017-2021, dhe përfshin gjithsej tre akte që lidhen me barazinë gjinore për tu lidhur me *Acquis-in* e BE-së, si dhe kërkon 15 masa zbatimi që përfshijnë treguesit që lidhen me gjininë.

IV. PKZMSA 2018-2022: Pasqyrë e Perspektivës Gjinore

PKZMSA 2018-2022 në një farë mase ka integruar perspektivën gjinore në të gjithë pjesët e saj narrative, megjithëse më dobët se vitin paraprak. Në fakt, duket se shumë nga aspektet gjinore të PKZMSA-s 2017-2021 thjesht janë kopjuar në draftin e ri. Një nga aspektet kryesore që mungon përfshin mungesën e një grupi punues përgjegjës për integrimin e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentin, siç është bërë në PKZMSA-në e mëparshme. Fatkeqësisht, Kuadri Logjik ekzistues i PKZMSA 2018-2022 pothuajse nuk ka fare perspektivë gjinore. Pasi që asnjë nga tre aktet që do të përafroheshin me legjislacionin e BE-së nuk u zbatuan gjatë vitit 2017, të tre u transferuan thjesht në PKZMSA 2018-2022. Sidoqoftë, PKZMSA 2018-2022 nuk ka tregues gjinorë që kërkojnë pjesëmarrje të barabartë në sektorë të ndryshëm. Rrjedhimisht, ndërsa PKZMSA 2017-2021 kërkon një pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në të gjithë treguesit, ku ishte i zbatueshëm sipas kërkesave të nenit 6.8 të Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore, PKZMSA 2018-2022 e fundit nuk i merr fare parasysh këto kërkesa.¹¹ Përfundimisht, PKZMSA 2018-2022 përfshin vetëm tre akte kombëtare për tu rreshtuar me *Acquis* të BE-së, si dhe tre Masa/Veprime Implementimi, duke parashikuar kërkesa shumë më të dobëta gjinore në krahasim me PKZMSA 2017-2021 dhe kërkesat e LBGJ për përfaqësim të barabartë. Kërkesat e LBGJ-së për përfaqësim të barabartë gjinor dhe integrimin gjinor janë shumë të drejta dhe shumë të rrepta. Për më tepër, këto kërkesa zbatohen

¹¹Neni 6.8 i Ligjit për barazi gjinore i Republikës së Kosovës "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse."

drejtpërdrejt për çdo version të PKZMSA. Konkretisht, LBGJ përcakton përfaqësim të pabarabartë si pjesëmarrje ose përfaqësim i një gjinie në nën 50% në çdo nivel të organit vendimmarrës në jetën.¹² Për më tepër, ajo deklaron se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet kur një përfaqësim minimal prej 50% për secilën gjini sigurohet në të gjitha institucionet, përfshirë organet gjyqësore, legislative dhe ekzekutive.¹³ Integrimi gjinor, nga ana tjetër, përcaktohet si përfshirja e një perspektive gjinore në të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe monitorimit të të gjithë legjislacionit, përfshirë politikat, programet dhe buxhetet.¹⁴ Ky përkufizim përfshin drejtpërdrejt të gjitha dokumentet strategjike, përfshirë versionet e ndryshme të azhuruara të PKZMSA. Për më tepër, përmes nenit 5 të LBGJ, përfshirja e çështjeve gjinore është paraparë si masë e përgjithshme për të parandaluar diskriminimin gjinor dhe bëhet detyrim ligjor për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës..¹⁵

V. PKZMSA 2017-2021 dhe 2018-2022: Përafrimi i akteve kombëtare me legjislacionin e BE-së

Të dyja dokumentet si PKZMSA, që mbulon periudhën 2017-2021 dhe PKZMSA, që mbulon periudhën 2018-2022 kanë disa kërkesa dhe tregues të gjinisë brenda vetes, përfshirë zbatimin e tre akteve kombëtare që duhet të harmonizohen me legjislacionin e BE-së. Për shkak të dështimit të zbatimit të akteve në vitin 2017, ato u zhvendosën në vitin 2018, pra, analiza më poshtë përqendrohet në të njëjtët tregues të përfshirë në kërkesat e planit të veprimit 2018.

V. a) Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Akti i parë i nxjerrë në pah për tu hartuar dhe zbatuar përfshin një akt nënligjor që rregullon zbatimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Institucionet e Kosovës.¹⁶ Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është integrimi i perspektivës gjinore përgjatë ciklit buxhetor, përfshirë edhe kohën gjatë planifikimit, hartimit, implementimit dhe vlerësimit të linjave të ndryshme buxhetore.¹⁷ Që nga viti 2015, BPGJ është bërë detyrim ligjor për të gjitha institucionet publike të Kosovës sipas kërkesave të Ligjit

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, 3.1.15, 2015, at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

¹³ Ibid. Neni 6.8

¹⁴ Ibid. Neni 3.1.16

¹⁵ Ibid. Neni 5

¹⁶ PKZMSA, Implementimi i Nenit 3 dhe 4 i MSA 3.24, Të drejtat themelore

¹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore No.05/L-020, 2015, at: www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf

Nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore.¹⁸ Në mënyrë specifike, ligji përkufizon se buxhetimi gjinor “është zbatimi i integritetit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve.”¹⁹ Për më tepër, Ligji për Barazi Gjinore detyron drejtpërdrejt të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të zbatojnë BPGJ.²⁰ Për vitin 2017, institucioni kryesor zbatues i regjistruar nën PKZMSA 2017-2021 ishte Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe Ministria e Financave (MF) që u konsiderua një institucion mbështetës për zbatimin e kësaj kërkesë specifike. Ky akt nënligjor është dashur të finalizohet në tremujorin e katërt të vitit 2017. Pasi që nuk është zbatuar në vitin 2017, ai u ri-përfshi në PKZMSA 2018-2022 me një afat të caktuar që të zbatohet në tremujorin e katërt të 2018. Përsëri, kjo kërkesë nuk ishte zbatuar gjatë vitit 2018.

Baza e të dhënave për monitorimin e kërkesave të PKZMSA 2017-2021 në lidhje BPGJ					
Kapitulli	Kërkesat	Institucioni implementues	Institucioni mbështetës	Afati kohor sipas PKZMSA 2017-2021	Statusi
Të drejtat themelore	Një akt nënligjor që rregullon zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në institucionet e Kosovës	ABGJ	MF	Çereku i katërt i vitit 2017	Nuk është implementuar në vitin 2017
Baza e të dhënave për monitorimin e kërkesave të PKZMSA 2018-2022 në lidhje BPGJ					
Të drejtat themelore	Një akt nënligjor që rregullon zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në institucionet e Kosovës	ABGJ	MF	Çereku i katërt i vitit 2018	Nuk është implementuar në vitin 2018

Siç u tha më lart, kërkesa nuk u zbatua gjatë vitit 2017 ose gjatë vitit 2018. Në fakt, asnjë hap konkret drejt përfundimit të tij nuk ka ndodhur. Ky është njëkohësisht edhe mos implementimi i një treguesi kryesor gjinor të PKZMSA 2017 dhe 2018, por gjithashtu nuk përmbush detyrimet ligjore të kërkuara nga Ligji për Barazi Gjinore. KIPRED-i ka zbuluar që Ministria e Financave nuk ishte në dijeni të

¹⁸Ibid.


¹⁹Ibid, neni 1.17

²⁰Ibid, neni 5.1.5

përgjegjësisë së tyre ndaj zbatimit të BPGJ sipas PKZMSA 2017 dhe 2018.²¹ Intervista me ABGJ-në ofroi një diapazon më të gjerë informacioni. Është vënë re se nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret rreth implementimit të këtij treguesi, si do që të jetë disa prej sfidave dhe nevojave janë identifikuar. Gjatë intervistës, përfaqësues të ABGJ-së deklaruan se “...Ky është një koncept i ri dhe se ne jemi duke e analizuar vetëm sa i thellë mund të jetë. Nuk është aq e thjeshtë sa të paraqitësh vetëm të dhëna të ndara gjinore dhe të tregosh pabarazi. Është një koncept shumë më i thellë nga sa mund të kishim imagjinuar fillimisht.”²² Agjencia për Barazi Gjinore më tej theksoi se ata aktualisht janë duke përdorur trajnime dhe analiza të ndikimit gjinor në mënyrë që të marrin më shumë informacion mbi atë që duhet të nënkuptojë vetë akti nënligjor. ABGJ beson se akti nënligjor do të përfundojë duke kërkuar ndryshime brenda vetë sistemit të menaxhimit financiar, për të cilin aktualisht nuk ka shumë vullnet.²³ Rrjedhimisht, duke thënë një gjë të tillë, kërkesa për BPGJ vazhdon të transferohet nga viti në vit pa hapa konkret të ndërmarrë në implementimin aktual të tij.

b) Indeksi gjinor

Indeksi i Barazisë Gjinore në BE është një mjet i analizës së mangësive gjinore midis grave dhe burrave në të gjithë Bashkimin Evropian. Indeksi bazohet në një vizion të një Bashkimi Evropian të barabartë gjinor, ku mirëqenia sociale, rritja dhe zhvillimi janë të barabartë për burrat dhe gratë.²⁴ Publikimi i tretë dhe më i ri u botua nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) në vitin 2017. Indeksi është një tregues i përbërë i cili mat konkretisht konceptin e barazisë gjinore dhe për më tepër ndihmon në monitorimin e përparimit të barazisë gjinore në të gjithë BE-në si dhe përgjatë gjithë kohës.²⁵ Indeksi përbëhet nga gjashtë fusha kryesore, si dhe dy fusha



"satelitore"/ndër sektoriale. Gjashtë fushat kryesore përfshijnë paranë, punën, kohën, njohuritë,

²¹KIPRED Intervistë me Ministrinë e Financave, gusht 2019

²²KIPRED Intervistë me Agjencinë për Barazi Gjinore, Korrik 2019

²³Ibid.

²⁴Instituti Evropian për Barazi Gjinore, Indeksi i Barazisë Gjinore 2017: Matja e barazisë gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2017

²⁵Ibid.

shëndetin dhe fuqinë. Dy fushat ndërlidhëse përfshijnë dhunën dhe pabarazitë kryqëzuese.²⁶ Secila fushë përbëhet nga disa indikatorë, që arrijnë në gjithsej 31 tregues të përdorur për të matur barazinë dhe pabarazinë në të gjitha këto fusha.

Me anë të PKZMSA 2017-2021 Kosova është zotuar për të hartuar Indeksit Gjitor të Kosovës. Edhe pse Kosova nuk është akoma pjesë e vendeve të BE-së, themelimi i Indeksit Gjitor gjatë procesit të pranimit në BE mund të ketë disa përfitime.²⁷ Pasja e indeksit gjitor në dispozicion në këtë pikë do të na ndihmonte në identifikimin e fushave që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, ku ne jemi konkretisht duke u ballafaquar me sfida në zbatim, të sigurojë ndërhyrje në politikë të bazuar, si dhe të na mundësojë që të gjurmojmë më mirë progresin i cili mund të ndodhë me kalimin e kohës, të identifikojmë arritjet dhe të identifikojmë fushat ku nevojiten më shumë ndërhyrje me qëllim të forcimit të barazisë gjinore në Kosovë.²⁸ Për më tepër, mbledhja e të dhënave të shpërndara gjinore është gjithashtu një detyrim i përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore.²⁹ Megjithatë, edhe pse Kosova është e zotuar të hartojë Indeksit Gjitor në vitin 2017, ky afat nuk është respektuar dhe nuk janë marrë veprime konkrete drejt implementimit të tij. Afati i dytë kohor që është caktuar për tremujorin e tretë për vitin 2018, por edhe ky afat nuk është respektuar dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret nga institucionet përgjegjëse. Institucioni udhëheqës për hartimin e Indeksit Gjitor është Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore, i mbështetur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

²⁶Ibid

²⁷Serbia, edhe pse nuk është shtete anëtare e BE-së, është bërë shteti i parë jo anëtar i BE-së cili ka arritur që të themelojë Indeksit Gjitor në vitin 2016, për më tepër: <https://eige.europa.eu/news/serbia-first-eu-candidate-country-produce-gender-equality-index?lang=en>

²⁸Banjaska dhe Farnsworth, Vendorsja e Indeksit të Barazisë Gjinore në Kosovë: Raport diskutimi, 2017, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20170131101550373.pdf>

²⁹ Ligji për Barazi Gjinore, neni 5.1.8

Baza e të dhënave për monitorimin e kërkesave të PKZMSA 2017-2021 në lidhje Indeksit Gjnor					
Kapitulli	Kërkesat	Institucioni implementues	Institucion i mbështetës	Afati kohor sipas PKZMSA 2017-2021	Statusi
Të drejtat themelore	Indeksi Gjnor për Kosovën, i hartuar	ABGJ	ASK	Tremujori i 4të 2017	Nuk është zbatuar në vitin 2017
Baza e të dhënave për monitorimin e kërkesave të PKZMSA 2017-2021 në lidhje Indeksit Gjnor					
Të drejtat themelore	Indeksi Gjnor për Kosovën, i hartuar	ABGJ	ASK	Tremujori i 3të 2018	Nuk është zbatuar në vitin 2018

Agjencia për Barazi Gjinore ka deklaruar se procesi për krijimin e indeksit është i ndërlikuar dhe është një kërkesë e përbashkët e agjencive. ABGJ varet në masë të madhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në mënyrë që të mbledhë të dhënat e nevojshme për finalizimin e Indeksit. Sipas ABGJ-së ky është një proces që po shkon shumë ngadalë, dhe se fillimisht duhet të mblidhen disa nga të dhënat themelore për të analizuar të paktën disa nga fushat të cilat kërkohen nga indeksi. Informacioni aktual tregon se disa takime ndërmjet ABGJ-së dhe ASK-së janë mbajtur gjatë vitit të kaluar. Në fakt, takimi i fundit ka ndodhur me 5 gusht 2019.³⁰ Sido që të jetë, me përjashtim të takimeve të shpeshta dhe mbledhjes së të dhënave bazë, finalizimi i Indeksit të Barazisë Gjinore nuk ka arritur të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në PKZMSA 2017-2021 dhe PKZMSA 20180-2022.

c) Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore është një dokument i politikave i cili do të hartohet dhe adaptohet nga Qeveria e Kosovës që përfshinë shtylla të ndryshme të intervenimit për të arritur barazinë gjinore në Kosovë, i cili gjithashtu parashihet në Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore. Programi i parë i miratuar ka mbuluar periudhën nga viti 2008 dhe ka përfunduar në vitin 2013, dhe që atëherë nuk është hartuar ndonjë program i ri. Sipas Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore është përgjegjëse për koordinimin dhe përgatitjen e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, monitorimin e zbatimit të tij dhe raportimin vjetor pranë Qeverisë rreth zbatimit të tij.³¹ Siç mund të shihet edhe më poshtë, Qeveria e

³⁰ Faqja elektronike e Agjencisë për barazi gjinore, e qasur më 4 tetor 2019, at: <https://abgj.rks-gov.net/>

³¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligji 5/L-020 mbi Barazinë Gjinore, neni 11, 2015, at: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

Kosovës është angazhuar për finalizimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore në tremujorin e katërt të vitit 2017. Pasi e kishte humbur këtë afat, ai u shty për tremujorin e katërt të vitit 2018. Programi gjithashtu nuk arriti të finalizohet as në vitin 2018. Në fakt, Raporti i BE-së për Kosovën i vitit 2019 ka nxjerrë në pah faktin se Programi i Kosovës për Barazi Gjinore ende nuk është adaptuar.³² Një draft i Programit është finalizuar dhe hedhur në diskutim publik në tremujorin e dytë të vitit 2019, dhe ABGJ shpreson që ky program të përfundojë dhe të adaptohet deri në fund të vitit 2019. Është fakt se Programi i Kosovës për Barazi Gjinore mbetet një veprimtari e pashfrytëzuar në tre vitet e fundit siç është cekur në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën 2019.

Të dhënat e monitorimit të kërkesave të PKZMSA 2017-2021 të programit për barazinë gjinore në Kosovë					
Kapitulli	Kërkesat	Institucioni implementues	Institucioni mbështetës	Afati i fundit sipas PKZMSA 2017-2021	Statusi
Të drejtat themelore	Programi për barazinë gjinore në Kosovë 2017-2021, i adoptuar	ABGJ	Ministritë përgjegjëse dhe komunat	Tre mujori i 4të i vitit 2017	Të pa zbatuara në vitin 2017
Të dhënat e monitorimit të kërkesave të PKZMSA 2017-2022 të programit për barazinë gjinore në Kosovë					
Të drejtat themelore	Programi për barazinë gjinore në Kosovë 2017-2021, i adoptuar	ABGJ	MAPL	Tre mujori i 4të i vitit 2018	Të pa zbatuara në vitin 2018

³² Komisioni Evropian, Komunikimi 2019 për politikën e zgjerimit të BE-së faqe 28, 2019, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

VI. PKZMSA 2017-2022 dhe 2018-2022: Masat e implementimit

a) Kërkesa lidhur me gjininë për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Sipas PKZMSA 2017-2021 dhe PKZMSA 2018-2022 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) kishte një matës të zbatueshmërisë në lidhje me gjininë të parashikuar të zbatohet gjatë vitit 2017 dhe një kërkesë të lidhur me gjininë në vitin 2018. Kërkesa sipas Kapitullit "Politika sociale dhe punësimi" për vitin 2017, kërkoi nga MPMS-ja që 5000 punëkërkues të trajnohen dhe të përfshihen në programe dhe projekte, duke respektuar kuotën gjinore. Më tej, në bazë të Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore sipas nenit 3.1.15 përcaktohet përfaqësimi i pabarabartë atëherë kur "pjesëmarrja ose përfaqësimi i një gjinie është më pak se pesëdhjetë përqind (50%) në çdo nivel të organit vendimmarrës në jetën politike dhe publike."³³ Sipas këtij neni, si dhe me faktin se kërkesat e tij iu transferuan PKZMSA 2017-2021 gjatë rishikimit nga OShC-të dhe bashkësisë ndërkombëtare, një përfaqësim i barabartë i burrave dhe grave është i detyrueshëm.

Të dhënat e monitorimit të kërkesave të PKZMSA 2017-2021 të programit për barazinë gjinore në Kosovë					
Kapitulli	Kërkesat	Institucioni implementues	Institucioni mbështetës	Afati i fundit sipas PKZMSA 2017-2021	Statusi
Politika sociale dhe punësimi	5000 punëkërkues të trajnuar dhe të përfshirë në programe dhe projekte, duke respektuar kuotën gjinore	MPMS		Tre mujori i 4të 2017	Të pa zbatuara
Të dhënat e monitorimit të kërkesave të NPISAA 2017-2022 të programit për barazinë gjinore në Kosovë					
Të drejtat themelore	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës	MPMS	ZKM	Tre mujori i 4të 2018	Të zbatuara me sukses

³³Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji No.05/L-020, Neni 3.5.15, at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

Kjo masë e parashikuar për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të thotë që të paktën 50% e të gjithë personave të trajnuar dhe të përfshirë në programe dhe projekte duhej të ishin gra gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017. Të dhënat e marra nga MPMS-ja tregojnë se gjithsej 5962 persona janë trajnuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2017. Nga kjo shifër, gjithsej 2047 (34.3%) ishin gra. Më tej të dhënat tregojnë se 2827 personave iu është siguruar punësim përmes masave aktive të tregut të punës gjatë kësaj periudhe, nga të cilët 1004 (35.5%) ishin gra. Të dhënat ilustrojnë se ndërsa kishte masa të suksesshme për të përfshirë gratë në trajnime, programe dhe projekte sipas masave aktive të tregut të punës, MPMS-ja nuk arriti të përfshijë një pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave, në përputhje me kërkesat e nenit të Ligjit të Kosovës për Barazi gjinore dhe sipas kërkesave të PKZMSA 2017-2021. Për më tepër, kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore për përfaqësim të barabartë duhet të jenë një kërkesë e vazhdueshme në të gjitha masat e lidhura me MSA-në të parapara me PKZMSA dhe nuk duhet të ishin lënë në harresë nga kërkesat aktuale të PKZMSA 2018-2022. Çdo ndryshim i ardhshëm i versionit aktual të PKZMSA, duhet të ketë në konsideratë kërkesat e LBGj-së në lidhje me përfaqësimin e barabartë kur të ri-hartohet. Duhet të theksohet se raporti mbi zbatimin e PKZMSA 2017-2021 nuk e rendit këtë kërkesë si kërkesë që nuk arriti të zbatohet, duke nënkuptuar që është zbatuar me sukses.³⁴ Gjithashtu PKZMSA e fundit 2018-2022 anashkaloj kërkesat për përfaqësim të barabartë të LBGj-së.

Për më tepër, MPMS-ja kishte një kërkesë të ndryshme lidhur me çështjet gjinore, nën kapitullin "Të drejtat Themelore", përkatësisht kërkesën që MPMS-ja, sipas ligjit të jetë institucioni drejtues në krijimin e mjeteve dhe sistemit të qëndrueshëm financiar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999. Kjo kërkesë është zbatuar me sukses dhe pa pengesa të mëdha ose vështirësi gjatë procesit. Fillimisht, në vitin 2016 MPMS-ja kishte filluar hartimin e Rregullores së Qeverisë së Kosovës 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë që ishte hartuar dhe aprovuar.³⁵ Komisioni për verifikim u formua dhe filloi punën e tij në 2017.³⁶ Deri në vitin 2018, sipas

³⁴ Ministria e Integritetit Evropian, Raporti i zbatueshmërisë për PKZMSA 2017-2021, Faqe 28, tek: Raporti për zbatueshmërinë <https://mei-ks.net/repository/docs/shqip2017.pdf>

³⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, Nr. rregullativ 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës, 2016, tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15049>

³⁶ Koha Ditore, "Pas tri vite pritjeje, formohet Komisioni për verifikimin e viktimave seksuale", 2017, artikulli i qasur më 4 tetor, 2019, tek: <https://www.koha.net/arberi/3815/pas-tre-vjet-pritjeje-formohet-komisioni-per-verifikimin-e-viktimave-seksuale/>

kërkesës brenda PKZMSA 2018-2022, janë pranuar gjithsej 909 aplikime, 491 prej të cilave janë aprovuar, 173 aplikime janë refuzuar dhe ka aplikime të tjera në pritje të miratimit.³⁷ Statusi aktual i zbatimit tregon që MPMS-ja kishte krijuar mjete dhe një sistem të qëndrueshëm financiar në njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës në Kosovë të viteve 1998-1999 sipas ligjit dhe rregullimit ligjor të Ministrisë. Kjo kërkesë është përmbushur.

b) Kërkesat gjinore për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Shërbimet e prokurorisë kosovare kishin disa kërkesa sipas PKZMSA 2017-2021, të gjitha në lidhje me rekrutimin e prokurorëve të rinj, personelin administrativ dhe rekrutimin e praktikantëve. Siç ilustron në të dhënat e më poshtme, KPK-ja jo gjithmonë iu është përmbajtur kërkesave të PKZMSA-as lidhur me gjininë, por në disa raste i ka tejkaluar ato. Për shembull, sipas PKZMSA 2017-2021, gjithsej 18 prokurorë të rinj janë dashur të dekretohen gjatë vitit 2018, me një përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave. Të dhënat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të Kosovës tregojnë se 13 prokurorë ishin dekretuar sipas Marrëveshjes së Brukselit, katër prej tyre ishin burra (30.7%) dhe nëntë gra (69.2%). Sipas PKZMSA 2017-2021, duhej të ishin emëruar gjithsej gjashtë prokurorë të rinj në Zyrën e Prokurorisë Speciale në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, vetëm pesë ishin emëruar, dy prej tyre ishin gra (40%) dhe tre burra (60%).³⁸

Sipas PKZMSA 2017-2021, gjithsej tre prokurorë ishte dashur të pranohen në njësinë për anti-korrupsion dhe krime ekonomike. Prokuroria e Shtetit të Kosovës ka mungesë të të dhënave të sakta se sa prokurorë janë pranuar gjatë vitit 2017, por vetëm tregon se gjatë gjithë vitit 2017 ishin 10 prokurorë që punonin brenda kësaj njësie. Nga këta 10, shtatë prokurorë janë burra (70%) dhe tre janë gra (30%).³⁹

Sipas një kërkesë tjetër të PKZMSA, nëntë zyrtarë të komunikimit duhej të punësoheshin brenda prokurorisë shtetërore të Kosovës në vitin 2017, duke marrë parasysh përfaqësimin e barabartë gjinor

³⁷ Informacioni i marrë përmes Sekretariatit të Komisionit për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës

³⁸Të dhënat e marra nga Akademia e Drejtësisë e Kosovës

³⁹Të dhënat e marra nga Akademia e Drejtësisë e Kosovës

të Ligjit për Barazi Gjinore. Të dhënat e marra nga Prokuroria e Shtetit të Kosovës tregojnë se asnjë nga zyrtarët e komunikimit nuk ishte i punësuar nga shërbimet e prokurorisë gjatë kësaj periudhe.

Një kërkesë tjetër ishte që 50 praktikantë të rinj duhej të kishin filluar punën në Prokurorinë e Kosovës gjatë vitit 2017. Sipas të dhënave të marra, gjithsej 147 praktikantë filluan praktikën në Prokurorinë e Kosovës në vitin 2017, 80 prej të cilave ishin gra (54.42%) dhe 67 prej të cilëve ishin burra (45.57%). Kjo masë specifike u tejkalua nga shërbimet prokuroriale të Kosovës.

Së fundmi, PKZMSA 2017-2021 kërkoj që gjithsej pesë zyrtarë të pranoheshin në sekretariatit e KPK-së gjatë gjithë vitit 2017. Në realitet, ishin punësuar katër zyrtarë, nga të cilët tri ishin gra (75%) dhe një burrë (25%).

Edhe pse përfaqësimi i barabartë mund të duket i tejkaluar në disa nga kërkesat në bazë të Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe PKZMSA 2017-2021 nga shërbimet prokuroriale ku ka pasur zakonisht më shumë gra të angazhuara si në rastin e praktikantëve, megjithatë kjo mund të shihet si një praktikë e mirë, për të kapërcyer dhe rritur numrin e grave në shërbime ku ato janë më pak të përfaqësuara se burrat. Siç është cekur nga Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën, sistemi i prokurorisë dhe gjykatave në Kosovë vazhdon të ketë më shumë burra sesa gra duke e lënë Kosovën mbrapa me vendet në rajon dhe gjithashtu me shtetet e BE-së kur bëhet fjalë për përfaqësim të barabartë gjinor të grave dhe burrave, veçanërisht brenda sistemit të gjykatave. BE ka vërejtur se në fillim të vitit 2019 ishin gjithsej 431 gjyqtarë nga të cilët 140 gra (32.48%) dhe 291 burra (67.51%). Brenda shërbimeve të prokurorisë kishte 191 prokurorë nga të cilët 77 gra (40.31%) dhe 114 burra (59.68%). Kjo tregon tendencën e përgjithshme që brenda shërbimeve prokuroriale dhe gjyqësore, gratë të mbeten më pak të përfaqësuara se burrat dhe ende nuk kanë arritur përfaqësimin e barabartë prej 50% siç kërkohet nga PKZMSA dhe Ligji për Barazi Gjinore. Si pasojë, Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën, vuri në dukje se Kosova vazhdon të ketë një përqindje të ulët të grave gjyqtare dhe prokurorë në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane.⁴⁰

Është shqetësuese që PKZMSA 2018-2022 nuk ka kërkesa që lidhen me gjininë, edhe pse rekrutimet e reja të prokurorëve dhe ngritja e kapaciteteve të prokurorëve të rinj të emëruar do të vazhdojnë në vitet e parashikuara për zbatimin e PKZMSA-së të re.

⁴⁰Faqe 17, Raportet e Progresit të BE-së për Kosovën, 2019. Mund të gjenden në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

c) **Kërkesat lidhur me gjininë për Akademinë e Drejtësisë të Kosovës**

Institucionet gjyqësore, veçanërisht Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), kishin disa tregues gjinorë për të përmbushur në përputhje me kërkesat e PKZMSA 2017-2021. Në të gjithë treguesit më poshtë, KPK-ja dhe KGJK-ja ishin vetëm institucione mbështetëse, ndërsa institucioni kryesor implementues ka qenë Akademia e Drejtësisë. Këto kërkesa kishin të bënin me ofrimin e trajnimeve për shërbimet prokuroriale dhe gjyqësore të Kosovës, duke respektuar kërkesat ligjore të pjesëmarrjes së barabartë gjinore në trajnime dhe nisma për ndërtimin e kapaciteteve.

Një nga kërkesat ishte të vazhdojnë reformat institucionale dhe të ndërtohet kapacitete institucionale në fushën e azilit me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit të përafuar. Për këtë temë, gjithsej shtatë gjyqtarë nga departamenti administrativ duhej të trajnoheshin, duke respektuar kuotën gjinore. Të dhënat e paraqitura në KIPRED nga Akademia e Drejtësisë tregojnë se një trajnim për këtë temë u mbajt në vitin 2017, me 17 pjesëmarrës. Fatkeqësisht, kuota gjinore nuk u respektua pasi 13 pjesëmarrës ishin burra (76.47%) dhe katër ishin gra (23.52%).

Për të njëjtën kërkesë, 10 gjyqtarë dhe pesë prokurorë duhej të trajnoheshin nga departamenti për krime të rënda dhe departamenti i përgjithshëm i gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, si dhe 25 prokurorë dhe 61 gjyqtarë të sapoemëruar, të trajnuar duke respektuar kuotën gjinore. Të dhënat e paraqitura tregojnë se gjithsej 25 aktivitete trajnuese mbi këtë temë u mbajtën në vitin 2017, me gjithsej 385 pjesëmarrës (174 gjyqtarë, 104 prokurorë dhe 106 të tjerë). Ndërsa niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes tejkaloj kërkesat e PKZMSA-së, ajo nuk i kaloi kërkesat në lidhje me gjininë ku nga të gjithë pjesëmarrësit, 241 ishin burra (62.60%) dhe 144 gra (37.40%)

Për më tepër, me të njëjtën kërkesë, Akademia e Drejtësisë ishte dashur të trajnojë 30 gjyqtarë dhe 20 prokurorë duke respektuar kuotën gjinore, me pjesëmarrës të ardhur nga departamenti i krimeve të rënda të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Në këtë temë u mbajtën gjithsej tetë aktivitete trajnimi / punëtori, me gjithsej 90 pjesëmarrës, 38 prej të cilëve ishin gjyqtarë, 27 prokurorë dhe 25 staf të tjerë, duke përfshirë bashkëpunëtorë profesional. Përsëri, ndërsa numri i përgjithshëm i profesionistëve të trajnuar tejkaloj kërkesat e PKZMSA 2017, ata nuk zbatuan me sukses kërkesat gjinore, pasi vetëm 32 nga të gjithë pjesëmarrësit ishin gra (35.55%) në krahasim me 58 prej të cilëve ishin burra (64.45%)

Sipas kërkesës "Intensifikimi i Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar", Akademisë së Drejtësisë iu kërkuar të trajnojnë dhjetë gjyqtarë dhe tetë prokurorë gjatë vitit 2017, duke siguruar një numër të barabartë burrash dhe gra të trajnuara. Asnjë trajnim nuk u mbajt nga Akademia e Drejtësisë për këtë temë gjatë vitit 2017 dhe aktiviteti u zhvendos për tu zbatuar gjatë vitit 2018.

Vlen të përmendet se PKZMSA 2018-2022 nuk parashikon ndonjë kërkesë lidhur me gjininë për aktivitetet e trajnimit të Akademisë së Drejtësisë, edhe pse mandati i tyre për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të vazhdojë edhe në vitet në vijim.⁴¹ Kjo tregon përsëri mungesën e integritit gjinor dhe mungesën e rishikimit të PKZMSA të fundit 2018-2022 nga një perspektivë gjinore që nuk është në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planin II të Veprimit Gjinor të BE-së në veçanti.⁴²

d) Kërkesat lidhur me gjininë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Edhe pse nuk kishte kërkesa në lidhje me gjininë në PKZMSA 2017-2021, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) duhej të mblidhte dhe mirëmbante rregullisht "numrin e pronave të regjistruara në Udhëzimin Administrativ Nr.03 / 2016 për masat afirmative për regjistrimin e pronave në emër të të dy bashkëshortëve."⁴³ Kjo kërkesë fillimisht doli nga Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2018 për masat speciale për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve.⁴⁴ Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ, i cili u transferua edhe në PKZMSA 2018, është rritja e numrit të grave të regjistruara si pronare të përbashkëta të pasurive të paluajtshme dhe ky udhëzim u miratua nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore nga Qeveria e Kosovës si një masë afirmative në mënyrë që të përshpejtohej shkalla e barazisë gjinore në lidhje me pronësinë në Kosovë, ku kryesisht mbizotërojnë burrat. Të dhënat e paraqitura në KIPRED nga MMPH tregojnë se numri i qytetarëve që regjistrojnë pronë sipas këtij Udhëzimi Administrativ është rritur në mënyrë

⁴¹ Është e rëndësishme të përmendet që Akademia e Drejtësisë megjithatë vazhdoi të punojë drejt sigurimit të përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave gjyqtarë dhe prokurorë në përpjekjet e tyre për ndërtimin e kapaciteteve.

⁴² Duhet shtuar se PKZMSA 2019-2023 e re e cila është në këtë moment jashtë objektit të kësaj analize, gjithashtu nuk përfshin ndonjë kërkesë lidhur me gjininë për Akademinë

⁴³ Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit 2018-2022, Kapitulli për Të Drejtat Themelore, Treguesi 3.24.81, tek: mei-ks.net/repository/docs/20180731115427_1_pkzmsa_2018-2022_final_miratuar_nga_kuvendi.pdf

⁴⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ No. 03/2-16 mbi masat speciale për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve, 2016, tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17698>

të vazhdueshme që kur ka hyrë në fuqi në vitin 2016. Për shembull, ndërsa 768 prona janë regjistruar në vitin 2016, ky numër është rritur në 1181 në 2017 dhe ishin regjistruar 1650 raste në 2018.

e) **Kërkesat gjinore nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**

Bazuar në Kapitullin "Të Drejtat Themelore", Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) kishte një tregues të ndjeshëm në lidhje me gjininë për tu zbatuar gjatë vitit 2018. Kjo përfshinte mirëmbajtjen e statistikave vjetore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve. Siç mund të vërehet, kjo është e njëjta kërkesë me atë të përmendur më lart si përgjegjësi e MMPH-së. Të kesh të njëjtin tregues që përsëritet dy herë për dy institucione është e tepërt, që tregon se duhet të ketë pasur mungesë të koordinimit gjatë përpilimit të seksioneve të PKZMSA-së nga ministrinë e ndryshme. Sidoqoftë, duhet të theksohet se MAPL nuk i dha këto dhëna edhe pse KIPRED vazhdimisht iu kërkoi, dhe as nuk i përfshiu ato në raportin e tyre vjetor. Edhe pse gratë mbesin të nën-përfaqësuara nëpër komuna të ndryshme në Kosovë, MAPL është duke ndihmuar drejt përmirësimit të kësaj situate. Proporcioni i pozitave të drejtorëve në Komuna është rritur nga 11% në 19% përgjatë viteve të kaluara.⁴⁵ Gjashtë nga 38 komunat nuk u janë përmbajtur kërkesave të ligjit për barazi gjinore lidhur me përfaqësimin e barabartë sa i përket komiteteve brenda asamblesë. MAPL ka lajmëruar këto komuna tek Ministria e Drejtësisë për të ndërmarrë masa ligjore.

f) **Gjetje të tjera: Kapacitetet institucionale në zbatimin e kërkesave në lidhje me gjininë**

Një nga objektivat kryesore në monitorimin e kërkesave në lidhje me gjininë nga Qeveria e Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe sipas politikave të përcaktuara në planet e veprimit të PKZMSA-së, ka qenë të analizojë kapacitetet e zyrtarëve dhe institucioneve të intervistuar. Intervistat gjysmë të strukturuar të zyrtarëve përgjegjës nga disa institucione përgjegjëse për zbatimin e kërkesave të PKZMSA-së lidhur me gjininë treguan se kapacitetet institucionale mbeten një problem i madh. Në fakt, mungesa e të kuptuarit të integritimit gjinor dhe rëndësia e kërkesave në lidhje me gjininë e Ligjit mbi Barazinë

⁴⁵ European Commission, Kosovo* 2019 Report, 2019, at: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Gjinore të vitit 2015 të Kosovës, i kërkuar në proceset e integrimit evropian brenda PKZMSA-së, duket se është një nga arsyt kryesore pse shumë aspekte zbatohen pjesërisht apo nuk zbatohen fare.

Asnjë nga zyrtarët e intervistuar nuk kishte ndonjë trajnim të kaluar për mënyrën e njohjes dhe identifikimit të treguesve përkatës të integrimit gjinor të pjesëve të analizës së situatës narrative, hollësisht e përcaktuar në planet e veprimit të PKZMSA-së dhe gjithashtu nuk kishin regjistruar si aktivitete të veçanta në kornizën logjike të planeve të veprimit. Në fakt, disa zyrtarë të intervistuar përmendën që asnjë prej kolegëve të tyre nuk kishte ndërmarrë trajnime përkatëse në lidhje me barazinë gjinore, pjesëmarrjen gjinore dhe përfshirjen e gjinisë ashtu siç parashihet me detyrimet e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore.⁴⁶ Mungesa e kuptimit të koncepteve lidhur me integrimin gjinor, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe kërkesat e tjera për barazi gjinore ishin të dukshme gjatë gjithë intervistave.

Disa nga zyrtarët e intervistuar nuk ishin të vetëdijshëm për pabarazitë ekzistuese gjinore në sektorin e tyre të punës. Kjo direkt pengon aftësinë e tyre për të hartuar aktivitete dhe tregues të ndjeshëm ndaj gjinisë, duke synuar konkretisht nevojat e burrave dhe grave në sektorin e tyre të punës. Për shembull, një zyrtar i intervistuar nga MPMS, deklaroi se "është e vështirë të përgjigjesh nëse ka barazi gjinore në institucionin tonë. Unë nuk mendoj se ka pabarazi gjinore ku ne punojmë. Por është shumë e vështirë t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje". Për më tepër, barazia gjinore ose mungesa e saj shpesh keqkuptohej si përfaqësim i barabartë vetëm brenda institucionit. Shpesh, zyrtarët prirën të tregojnë një numër të burrave dhe grave, kur pyeten nëse ata janë të vetëdijshëm për sfidat që lidhen me pabarazitë gjinore në përgjithësi ose brenda sektorëve të tyre të punës.

Terminologjia e zakonshme si analiza gjinore, treguesit e ndjeshëm ndaj gjinisë dhe integrimi gjinor nuk ishte e njohur për institucionet e intervistuar, të cilët gjithashtu nuk ishin në gjendje të ofronin një përshkrim të përshtatshëm në përputhje me kërkesat e ligjit për barazi gjinore. Më e rëndësishmja, personat përgjegjës për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor brenda vetë Ministrisë së Financave, nuk ishin të vetëdijshëm se çfarë përfshin ky term, duke e keqkuptuar atë si buxhet shtesë për Agjencinë për Barazi Gjinore.⁴⁷

⁴⁶Intervistat e KIPRED me MMPH, MAPL, dhe MF

⁴⁷ Intervista e KIPRED me MF

VII) Përfundime dhe rekomandime

Ky raport ka nxjerrë në pah disa probleme në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore, përfaqësimin e barabartë dhe treguesit e ndjeshëm gjinor gjatë planeve të monitoruara të veprimit të Qeverisë së Kosovës për të zbatuar marrëveshjen e MSA-së të njohur si PKZMSA 2017-2021 dhe 2018-2021. PKZMSA 2017-2021 kishte konsultuar ekspertizën gjinore para përfundimit, dhe kështu ajo përmban një perspektivë gjinore në të gjithë pjesën e saj narrative, si dhe në kornizën e saj logjike. Nga ana tjetër, PKZMSA 2018-2022 pothuajse plotësisht i mungon kjo perspektivë për shkak të mungesës së këshillimit dhe koordinimit të kontributit me shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe ekspertët e gjinisë. Për më tepër, shumë prej indikatorëve që janë kërkuar nën PKZMSA 2017-2021 nuk janë zbatuar dhe janë zhvendosur për zbatim në PKZMSA 2018-2022. Treguesit që lidhen me veprimet nacionale për tu përafuar me legjislacionin e BE-së kanë humbur të dy afatet fillestare, përfshirë këtu të parin në 2017 dhe të dytin në 2018. Kjo përfshin Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, Indeksin e Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe një akt nënligjor që rregullon Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor. Në fakt, këto kërkesa u zhvendosën në 2018, dhe nuk arritën të zbatohen edhe një herë gjatë vitit 2018 dhe janë në pritje të zbatimit gjatë vitit 2019. Më tej, raporti tregon se përfaqësimi i barabartë gjinor i kërkuar si nga PKZMSA, por edhe përmes Ligjit për Barazi Gjinore shpesh injorohet nga shumë institucione relevante, veçanërisht kur përqendrimi është në rekrutimin e personelit të ri. Hulumtimi tregon më tej probleme të vazhdueshme në kapacitete dhe njohuri themelore në lidhje me barazinë gjinore nëpër institucione. Këto mungesa të kapaciteteve përfshijnë mungesë njohurish mbi kërkesat LBGJ dhe PKZMSA që kanë të bëjnë me integrimin gjinor dhe barazinë gjinore, por gjithashtu njohuri shumë të ulëta në kërkesat lidhur me gjininë dhe çështjet e barazisë gjinore brenda sektorëve të tyre të punës. Në përgjithësi, hulumtimi ka treguar se barazia gjinore, integrimi gjinor dhe parimet e barabarta të përfaqësimit janë vazhdimisht duke u lënë pas dore gjatë gjithë procesit të rishikimit dhe hartimit të MSA-së së re dhe miratimit të planeve të reja të veprimit të PKZMSA-së. Institucionet përkatëse duhet të ndërmarrin veprime të shpejta për të përmirësuar këtë proces, pasi Qeveria e Kosovës do të rrezikojë plotësisht mundësinë për të plotësuar kërkesat tona të lidhura me gjininë ashtu siç kërkohet nga Plani i Veprimit për Gjininë II të BE-së dhe dokumentet e tjera të lidhura, gjatë proceseve të saj të integritimit në BE.

Rekomandime:

Për Qeverinë e republikës së Kosovës:

- Të ushtrohet presion përmes kërkimit të raporteve të rregullta dhe koordinimit të duhur me ministrinë përgjegjëse për zbatimin e kërkesave lidhur me gjininë nga PKZMSA.
- Të krijohet një sistem të përmirësuar monitorimi dhe zhvillohet një pyetësor për vlerësimin e nivelit të zbatimit të kërkesave të PKZMSA lidhur me gjininë.
- Të sigurohet që të gjitha ministrinë dhe institucionet e tjera përgjegjëse të jenë të vetëdijshëm që integrimi gjinor në PKZMSA nuk është vetëm një kërkesë e OSHC-ve, por një kërkesë e detyrueshme sipas legjislacionit ekzistues në Kosovë.
- Të sigurohet një sistem më i mirë i koordinimit ndërmjet ministrive përgjegjëse dhe institucioneve të tjera kur hartojnë versionet e ardhshme të PKZMSA-së.
- Të mbahen përgjegjëse ministrinë dhe institucionet e tjera të rëndësishme përgjegjëse për zbatimin/dështimin e zbatimit të kërkesave të PKZMSA-së lidhur me gjininë.

Për Ministrinë e Integritimit Evropiane

- Të rritet koordinimi ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse kur hartohen kërkesat e PKZMSA-së lidhur me gjininë
- Të sigurohen trajnime themelore për zyrtarët e Integritimit Evropian për barazinë gjinore, analizën gjinore, integrimin gjinor.
- Të sigurohen ngritje e kapaciteteve për zyrtarët e Integritimit Evropian për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e objektivave, aktiviteteve dhe treguesve të ndjeshëm ndaj gjinive.
- Të sigurohet që ekspertët e jashtme të gjinisë, përfshirë ato të OSHC-ve të grave, të konsultohen gjatë përpilimit të PKZMSA ashtu siç u bë për PKZMSA 2017-2021. Kjo ka qenë një praktikë e dëshmuar më e mirë në përmirësimin e ndjeshmërisë gjinore brenda programit.

Për Agjencinë për Barazi Gjinore:

- Ndërsa PKZMSA e ardhshme është duke u hartuar, sigurohuni që planifikimi i akteve nënligjore dhe masave të tjera ligjore brenda tij janë realiste dhe sigurojnë kohë të mjaftueshme për t'u planifikuar, hartuar, konsultuar dhe përfunduar.

- Të bëhet një plan konkret për hartimin dhe përfundimin e akteve nënligjore për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator. Takohuni rregullisht me zyrtarë të Ministrisë së Financave që nuk kanë dijeni për përgjegjësitë e tyre që rrjedhin nga PKZMSA 2017-2021 dhe 2018-2022 në BPGJ.
- Siguroni që të merren masa konkrete për finalizimin e Indeksit të Barazisë Gjimore. Nëse mbledhja e të gjitha të dhënave për indeksin është sfiduese, mblidhni disa të dhëna për të përfunduar tregues të caktuar.
- Kërkoni mbështetje të jashtme në rritjen e kapaciteteve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës me qëllim të përfundimit të Indeksit të Barazisë Gjimore.

Për Bashkimin Evropian

- Të luajë një rol aktiv në heqjen e presionit drejt zbatimit të kërkesave të MSA-së lidhur me gjininë, të pasqyruara në PKZMSA.
- Ushtroni presion mbi institucionet e Kosovës drejt këshillimit të ekspertëve gjinator dhe OShC-ve të grave gjatë hartimit të PKZMSA-së dhe monitorimit të zbatimit të PKZMSA-së.
- Në lidhje me kërkesat e BE-së sipas Planit të Veprimit Gjinator të BE-së II, monitoroni me kujdes nëse perspektiva gjimore është përfshirë në të gjithë hartimet e PKZMSA-së, si në pjesën narrative, ashtu edhe në Kornizën Logjike.
- Sigurohuni që objektivat dhe treguesit e GAP II të BE-së janë përfshirë në PKZMSA, nën kapitujt përkatës.

Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian⁴⁸

- Njihni rregullisht rëndësinë e kërkesave të PKZMSA-së lidhur me gjininë dhe zbatimin e tyre.
- Bëni rregullisht pyetje në lidhje me statusin e barazisë gjimore / kërkesave në lidhje me gjininë brenda PKZMSA-së.
- Mbaj përgjegjës ministritë dhe institucionet e tjera të rëndësishme për zbatimin / dështimin e zbatimit të kërkesave të PKZMSA-së lidhur me gjininë.

⁴⁸ Kosova sapo ka dalë nga Zgjedhjet Parlamentare më 6 tetor 2019. Pas votimit të deputetëve të rinj të Kuvendit dhe votimit të deputetëve të saj, do të ngrihen edhe Komisionet. KIPRED synon të ndajë rekomandimet e tij me Komisionin përkatës që adreson çështje që lidhen me Integritetin Evropian.

Bibliografia

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji 05/L-020 në Barazinë Gjinore, Neni 5.1.3. 2015, tek: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf> Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, Indeksi për Barazinë Gjinore 2017: Matja e Barazisë Gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2017

Banjska dhe Farnsworth, Vendosja e Indeksit të Barazisë Gjinore në Kosovë: fletë diskutimi, 2017, tek: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20170131101550373.pdf>

Marrëveshja e Këshillit të Evropës, Stabilizim dhe Asociim ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës *, 2015, në: <data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>
Komisioni Evropian, Komunikimi, Komunikimi 2019 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së, faqja 28, 2019, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Komisioni Evropian, Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së, 2016-2020, 2015, në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf

Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjenda e Reformës Evropiane, 2016, në: mei-ks.net/repository/docs/20170929090420_erafinalsq.pdf

Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2018-2022, Kapitulli për të Drejtat Themelore, Treguesi 3.24.81, në: mei-ks.net/repository/docs/20180731115427_1_pkzmsa_2018-2022_final_miraturar nga kuvendi.pdf

Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (NPISAA), 2017-2021, faqe 9, në: <http://mei-ks.net/repository/docs/pkzmsa20172021ang.pdf>

Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 03 / 2-16 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Përbashkëta në Emër Të Të Dy Bashkëshortëve, 2016, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17698>

Seksioni hyrës i Raportit të Ministrisë së Integritetit Evropian "Raporti Final mbi Zbatimin e Agjendës së Reformës Evropiane 2016-2018", Dhjetor 2018. Në dispozicion në http://mei-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016-30_11_2018_final_eng.PDF
Koha Ditore, "Pas tri vite pritje, formohet Komisioni për Verifikimin e Viktimave Seksuale" 2017, Artikulli qasur me datë 4 tetor, 2019, në: <https://www.koha.net/arberi/3815/pas-tre-vjet-pritjeje-formohet-komisioni-per-verifikimin-e-viktimave-seksuale/>

Serbia, edhe pse jo një shtet anëtar i BE-së, u bë shteti i parë jo anëtar i BE që themeloi Indeksin e Gjinisë në vitin 2016. Për më shumë shikoni: <https://eige.europa.eu/news/serbia-first-eu-candidate-country-produce-gender-equality-index?lang=en>

Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.22 / 2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës, 2016, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15049>
Uebfaqja e Agjencisë për Barazi Gjinore, qasur më 4 Tetor 2019, në: <https://abgj.rks-gov.net/>

IX Shtojcë

Personat dhe institucionet e intervistuar			
Emri	Mbiemri	Pozita	Institucioni
Edi	Gusia	Shefe e Zyrës, Agjencia për Barazi Gjinore	Agjencia për Barazi Gjinore
Hanumshahe	Latifi	Departamenti për Integrim Evropiane dhe Koordinim i Politikave	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë
Rexhep	Vasolli	Departamenti për Integrim Evropiane dhe Koordinim i Politikave	Ministria e Financave
Lulzim	Karaxha	Departamenti për Integrim Evropiane dhe Koordinim i Politikave	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Hazbije	Krasniqi	Departamenti për Integrim Evropiane dhe Koordinim i Politikave	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
Shkëlqim	Jakupi	Departamenti për Integrim Evropiane dhe Koordinim i Politikave	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Reyes	Charle-Cuellar	Këshilltar për gjininë	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
Luljeta	Hetemi	Ushtrues i detyrës së drejtorit	Akademia e Drejtësisë
Astrit	Hoti	Shefi i Departamentit Ligjor	Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Ky grant mbështetet nga “Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe menaxhohet nga Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet nuk paraqesin pozicionin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe Fondacionit Kosovar të Shoqërisë Civile (KCSF).



Norwegian Embassy



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION